



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 426/7 prot.**

**Datë 29.02.2024**

**V E N D I M**  
**Nr. 228/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK nga autoriteti kontraktor në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK me NIPT K92006501A dhe adresë: Lagjia 6, Rruga “Shoqëria Bashkimi”, Pallati Clas, kati i parë, Durrës.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km.8, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Patos.

Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza, Patos.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraparak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datën 21.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Erisoni Company” SHPK, me nr. 426/2024 prot., datë 22.02.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3816, datë 21.02.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Në datën 22.02.2024, është protokolluar me nr.426/2, dokumenti bankar që vërteton, se operatori ekonomik ankimues ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2.3 Me shkresën nr.543/8 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën me 426/3 prot., datë 28.02.2024, (dërguar në adresën e emailit të KPP-së), është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe vendimi i KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës si më poshtë:

[...] 1. Lidhur me pikën 1 të ankesës së paraqitur, ku operatori ekonomik "ERISONI COMPANY" shpk deklaroi se nga ana e AK nuk është publikuar numri i llogarisë së AK-së dhe banka në të cilën ndodhet ky numër llogarie për të mundësuar kryerjen e sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare, bëjme me dije se: gabimisht numri i llogarisë bankare nuk është vendosur dhe do të vendoset në shtojcën për ndryshimin e dokumenteve të tenderit që do të paraqitet në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), konkretisht: 3.1.2 Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor Nr. llogarie: AL09202210050000000304030790 KODI i institucionit 2112001.

**Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe do të bëhet plotësimi përkatës nëpërmjet shtojcës.**

2. Lidhur me pikën 2 të ankesës, ku operatori ekonomik ankimues kërkon modifikimin e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.6 në DST, duke hequr formulimin "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ distributorit si fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij", KSHA vlerëson se: Objekti i prokurimit është "Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike" ku rëndësi ka kryerja e shërbimit dhe jo malli i cili do të kryejë këtë shërbim pasi këto pajisje në përfundim të afatit të shërbimit nuk do të kalojnë në pronësi të Autoritetit

*Kontraktor. Për rrjedhojë, KSHA argumenton se kriteri i mësipërm nuk është kriter vlerësues/matës i kapacitetit të operatorit ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë.*

***Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe do të bëhet modifikimi përkatës nëpërmjet shtojcës.***

*3. Lidhur me pikën 3 të ankesës, ku operatori ekonomik kërkon modifikimin e kriterit 2.3.4 lidhur me dokumentacionin që duhet të disponojë automjeti i kërkuar, konkretisht certifikata e transportit, KSHA argumenton se:*

*Për sa kohë nuk ka një përcaktim të llojit të automjetit të kërkuar në Dst, disponimi i certifikatës së transportit është variabël sipas llojit të mjetit, prandaj përcaktimi i modifikuar në Dst për këtë dokument nga "Çertifikatë transporti" në "Çertifikate transporti nëse është e aplikueshme" do të ishte i drejtë dhe nuk lë hapësirë për paqartësi.*

***Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe do të bëhet modifikimi përkatës nëpërmjet shtojcës.***

*Përfundimisht, bëjmë me dije se ankesa e operatorit ekonomik "ERISONI COMPANY" shpk për objektin e prokurimit "Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike", pranohet plotësisht.*

II.3. Në datën 22.02.2024, nëpërmjet shërbimit postar, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK, me nr. 428/2024 prot., datë 22.02.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3.1. Ankesa e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK është administruar në datën 22.02.2024, edhe nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, protokolluar me nr.428/1 prot., datë 22.02.2024.

II.3.2. Në datën 23.02.2024, është protokolluar me nr.428/3, dokumenti bankar që vërteton, se operatori ekonomik ankimues ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikën 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

II.3.3. Nëpërmjet komunikimit elektronik (postës elektronike), me shkresën nr.543/7 prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën me 428/4 prot., datë 28.02.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe vendimi i KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "InfoSoft Office" SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës si më poshtë:

*[...] Lidhur me pikën 1 të ankesës së paraqitur, ku operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk vlerëson si "të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me Standartet TIK 2023-2024" parametrat e pajisjeve të kërkuara, të pasqyruara në Formularin e specifikimeve teknike (Shtojca 5) për pajisjet e mëposhtme,*

....

*Pajisja multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati A4. Color, e kërkuar në DST ka specifikat e mëposhtme:*

*Shpejtësia:  $\geq 20$  faqe/min*

*Memoria: 2GB/320 GB HDD*

*Resolucioni i printimit: jo më i vogël se 1200x1200 dpi*

*Në analogji, pajisja Color Copy Machine A4 (standartet TIK, faqja 17) ka parametrat e mëposhtëm:*

*Shpejtësia:  $\geq 20$  faqe/min*

*Memoria:  $\geq 256$  MB*

*Hard Disk: Nuk specifikohet*

*Në krahasimin e parametrave të mësipërm për këto 2 pajisje, duke vlerësuar edhe qëllimin e përdorimit të pajisjes së kërkuar nga AK, KSHA argumenton se parametrat:*

*Memoria:  $\geq 256$  MB dhe rezolucioni printimit jo më i vogël se 600x600 dpi janë të mjaftueshme për përmbushje të funksionit për pajisjen multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati A4- Color dhe parametrat në DST.*

*Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.*

*2 Lidhur me pikën 2 të ankesës së paraqitur, ku operatori ekonomik ankimues kërkon ndryshimin e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.6 në DST, duke hequr formulimin "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij", KSHA vlerëson se:*

*Ashtu sikurse përcaktohet në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik të cituar nga operatori ekonomik ankimues "InfoSoft Office" shpk, objekti i prokurimit është "Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike" ku rëndësi ka kryerja e shërbimit dhe jo malli i cili do të kryejë këtë shërbim pasi këto pajisje në përfundim të afatit të shërbimit nuk do të kalojnë në pronësi të Autoritetit Kontraktor. Për rrjedhojë, KSHA argumenton se kriteri i mësipërm nuk është kriter vlerësues/matës i kapacitetit të operatorit ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë.*

*Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron plotësisht.*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Erisoni Company" SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës të autoritetit kontraktor nr.543/8 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën me 426/3 prot., datë 28.02.2024, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës si më poshtë:

[...] 1. Lidhur me pikën 1 të ankesës së paraqitur, ku operatori ekonomik "ERISONI COMPANY" shpk deklaroi se nga ana e AK nuk është publikuar numri i llogarisë së AK-së dhe banka në të cilën ndodhet ky numër llogarie për të mundur kryerjen e sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare, bëjme me dije se: gabimisht numri i llogarisë bankare

nuk është vendosur dhe do të vendoset në shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit që do të paraqitet në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), konkretisht: 3.1.2 Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor Nr. llogarie: AL09202210050000000304030790 KODI i institucionit 2112001.

**Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe do të bëhet plotësimi përkatës nëpërmjet shtojcës.**

2. Lidhur me pikën 2 të ankesës, ku operatori ekonomik ankimues kërkon modifikimin e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.6 në DST, duke hequr formulimin "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ distributorit si fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij", KSHA vlerëson se: Objekti i prokurimit është "Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike" ku rëndësi ka kryerja e shërbimit dhe jo malli i cili do të kryejë këtë shërbim pasi këto pajisje në përfundim të afatit të shërbimit nuk do të kalojnë në pronësi të Autoritetit Kontraktor. Për rrjedhojë, KSHA argumenton se kriteri i mësipërm nuk është kriter vlerësues/ matës i kapacitetit të operatorit ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë.

**Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe do të bëhet modifikimi përkatës nëpërmjet shtojcës.**

3. Lidhur me pikën 3 të ankesës, ku operatori ekonomik kërkon modifikimin e kriterit 2.3.4 lidhur me dokumentacionin që duhet të disponojë automjeti i kerkuar, konkretisht certifikata e transportit, KSHA argumenton se:

Për sa kohë nuk ka një përcaktim të llojit të automjetit të kerkuar në Dst, disponimi i certifikatës së transportit është variabël sipas llojit të mjetit, prandaj përcaktimi i modifikuar në Dst për këtë dokument nga "Çertifikatë transporti" në "Çertifikate transporti nëse është e aplikueshme" do të ishte i drejtë dhe nuk lë hapësirë për paqartësi.

**Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe do të bëhet modifikimi përkatës nëpërmjet shtojcës.**

Përfundimisht, bëjmë me dije se ankesa e operatorit ekonomik "ERISONI COMPANY" shpk për objektin e prokurimit "Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike", pranohet plotësisht.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në

dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës së autoritetit kontraktor nr.543/8 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën me 426/3 prot., datë 28.02.2024, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranimit plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik "Erisony Company" SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "InfoSoft Office" SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar shkresës të autoritetit kontraktor nr. 543/7 prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 428/4 prot., datë 28.02.2024, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimit pjesërisht të ankesës, duke pranuar kërkesat si me poshtë:

*[...] Lidhur me pikën 1 të ankesës së paraqitur, ku operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk vlerëson si "të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me Standartet TIK 2023-2024" parametrat e pajisjeve të kërkuara, të pasqyruara në Formularin e specifikimeve teknike (Shtojca 5) për pajisjet e mëposhtme,*

....

*Pajisja multifunktionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati A4. Color, e kërkuar në DST ka specifikat e mëposhtme:*

*Shpejtësia:  $\geq 20$  faqe/min*

*Memoria: 2GB/320 GB HDD*

*Resolucioni i printimit: jo më i vogël se 1200x1200 dpi*

*Në analogji, pajisja Color Copy Machine A4 (standartet TIK, faqja 17) ka parametrat e mëposhtëm:*

*Shpejtësia:  $\geq 20$  faqe/min*

*Memoria:  $\geq 256$  MB*

*Hard Disk: Nuk specifikohet*

*Në krahasimin e parametrave të mësipërm për këto 2 pajisje, duke vlerësuar edhe qëllimin e përdorimit të pajisjes së kërkuar nga AK, KSHA argumenton se parametrat:*

*Memoria:  $\geq 256$  MB dhe rezolucioni printimit jo më i vogël se 600x600 dpi janë të mjaftueshme për përmbushjen e funksionit për pajisjen multifunktionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati A4- Color dhe parametrat në DST.*

*Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.*

*2 Lidhur me pikën 2 të ankesës së paraqitur, ku operatori ekonomik ankimues kërkon ndryshimin e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.6 në DST, duke hequr formulimin "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij", KSHA vlerëson se:*



Ashtu sikurse përcaktohet në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik të cituar nga operatori ekonomik ankimes "InfoSoft Office" shpk, objekti i prokurimit është "Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike" ku rëndësi ka kryerja e shërbimit dhe jo malli i cili do të kryejë këtë shërbim pasi këto pajisje në përfundim të afatit të shërbimit nuk do të kalojnë në pronësi të Autoritetit Kontraktor. Për rrjedhojë, KSHA argumenton se kriteri i mësipërm nuk është kriter vlerësues/matës i kapacitetit të operatorit ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron plotësisht.

III.2.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.2.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i cili parashikon shprehimisht se : "1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.2.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, nga verifikimi i shkresës së autoritetit kontraktor nr.543/7 prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën me 428/4 prot., datë 28.02.2024, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik "Infosoft Office" SHPK. Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 428 prot., datë 22.02.2024, të operatorit ekonomik "Infosoft Office" SHPK.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "Infosoft Office" SHPK, i cili kërkon ndryshime në lidhje me specifikimet teknike si vijon:

**1. Për pajisjen:**

**Pajisje Multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner)  
Formati – A3, A4; Bardh e zi Sasia 3 Cope**

Autoriteti kontraktor të bëjë ndryshimet e specifikimeve teknike në lidhje me

**Resolucioni i printimit**

Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi

Të bëhet ndryshimi I këtij parametri/ specifikimi teknik, duke i përcaktuar ato sipas specifikimeve të miratura për këto lloj pajisjesh nga AKSHI, pra të vendoset "Rezolucioni" të jetë: min 300x300 dpi OSE të hiqet si specifikim teknik sikurse përcaktohet në "Standardeve TIK-2023-2024" të hartura dhe të miratuara nga AKSHI (Faqet 11, 25).

Në lidhje me

**Memoria**

2 GB / 320 GB HDD

Të bëhet ndryshimi i këtij parametri/ specifikimi teknik, duke i përcaktuar ato sipas specifikimeve të miratura për këto lloj pajisjesh nga AKSHI, pra të vendoset " Memoria " të jetë: Ram te jetë  $\geq 1$  gb dhe memoria HDD te jet e  $\geq 250$  GB, sikurse përcaktohet në "Standardeve-TIK- 2023-2024" të hartura dhe të miratuara nga AKSHI.

**2. Për pajisjen:**

**Pajisje Multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner)  
Formati – A3 – Color Sasia 2 cope**

Kërkojmë ndryshimin e parametrave

Rezolucioni i printimit të ndryshohet dhe të kërkohet: minimumi 600x600dpi, ose të hiqet si specifikim teknik sikurse përcaktohet në "Standardeve TIK-2023-2024" të hartura dhe të miratuara nga AKSHI (Faqet 11, 25).

Gjithashtu edhe kërkesa për " Memoria 2 GB/320GB HDD" të ndryshohet dhe të jetë memoria Ram të jetë  $\geq 256$ MB dhe memoria HDD të jetë  $\geq 250$ GB, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 5 "Formulari i Specifikimeve Teknike" të dokumenteve të tenderit, ka përcaktuar specifikimet teknike si më poshtë:

**Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Për te realizuar sistemin e shërbimit te printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen sasia e pajisjeve te mëposhtme.

### Specifikimet e pajisjeve dhe shërbimit

<b>Pajisje Multifunktionale (Printer, Fotokopje, Skaner)</b> <b>Formati – A3, A4; Bardh e zi, Sasia 3 Cope</b>	
<b>Teknologjia</b>	Lazer/Bardhe zi
<b>Shpejtesia</b>	Jo me e vogel 30 faqe/min
<b>Resolucioni i printimit</b>	Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi
<b>Kapaciteti mbajtes i sirtareve</b>	Jo me i vogel 500 faqe
<b>Kapaciteti ne dalje</b>	Jo me i vogel 300 faqe
<b>Madhesia e letres</b>	A6-A3
<b>Memoria</b>	2 GB / 320 GB HDD
<b>Lidhja</b>	Ethernet, USB
<b>Skanimi</b>	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
<b>ARDF</b>	50 faqe
<b>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</b>	Po

<b>Pajisje Multifunktionale (Printer, Fotokopje, Skaner)</b> <b>Formati – A4 – Bardh e zi Sasia 8 cope</b>	
<b>Teknologjia</b>	Lazer/Bardhe zi
<b>Shpejtesia</b>	Jo me e vogel 30 faqe/min
<b>Resolucioni i printimit</b>	Jo me i vogel 600 x 600 dpi
<b>Kapaciteti mbajtes i sirtareve</b>	Jo me i vogel 300 faqe
<b>Kapaciteti ne dalje</b>	Jo me i vogel 200 faqe
<b>Madhesia e letres</b>	A6-A4
<b>Memoria</b>	512 MB

<b>Lidhja</b>	Ethernet, USB
<b>Skanimi</b>	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
<b>ARDF</b>	30 faqe
<b>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</b>	Po

**Pajisje Multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner)  
Formati – A3 – Color Sasia 2 cope**

<b>Teknologjia</b>	Lazer/Me ngjyra
<b>Shpejtesia</b>	Jo me e vogel 20 faqe/min
<b>Resolucioni i printimit</b>	Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi
<b>Kapaciteti mbajtes i sirtareve</b>	Jo me i vogel 500 faqe
<b>Kapaciteti ne dalje</b>	Jo me i vogel 200 faqe
<b>Madhesia e letres</b>	A6-A3
<b>Memoria</b>	2 GB / 320 GB HDD
<b>Lidhja</b>	Ethernet, USB
<b>Skanimi</b>	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
<b>ARDF</b>	50 faqe
<b>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</b>	Po

**Pajisje Multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner)  
Formati – A4 – Color Sasia 2 cope**

<b>Teknologjia</b>	Lazer/Me ngjyra
<b>Shpejtesia</b>	Jo me e vogel 20 faqe/min
<b>Resolucioni i printimit</b>	Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi
<b>Kapaciteti mbajtes i sirtareve</b>	Jo me i vogel 500 faqe
<b>Kapaciteti ne dalje</b>	Jo me i vogel 200 faqe
<b>Madhesia e letres</b>	A4
<b>Memoria</b>	2 GB / 320 GB HDD
<b>Lidhja</b>	Ethernet, USB
<b>Skanimi</b>	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
<b>ARDF</b>	50 faqe
<b>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</b>	Po

- **Software për menaxhimin dhe monitorimin e pajisjeve te printimit dhe shërbimit.**

Menaxhimi dhe kontrolli i realizimit te shërbimit ne sasi e cilësi do te behet me pajisje **Software**. Per Software te menaxhimit te pajisjeve te printimit, operatori duhet te kete akses vetem ne shikimin e numrit te faqeve te printuara dhe fotokopjuara, nderkohe qe do te jete Sektori Ekonomik, qe do te beje menaxhimin e dokumentave te fotokopjuara dhe skanuara.

<b>Software për monitorimin dhe menaxhimin e pajisjeve te printimit</b>	
1	Monitorimin i statusit te pajisjeve ne kohe reale.
2	Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve ne mënyrë te centralizuar. Krijimi I profileve te ndryshme te printimit, skanimit me ane te Software dhe shpërndarjen e konfigurimit te te gjithë pajisjet, një grup apo disa pajisje ne mënyrë automatike.
3	Raportim me e-mail për sasinë e printimeve te secilit user (nëse aplikohet), te gjithë pajisjeve apo nje grupi te tyre.
4	Menaxhimin e pajisjeve me usera ( <i>nëse kërkohet</i> ) dhe konfigurimet përkatëse ne mënyrë te centralizuar.
5	Ruajtja e raporteve ne server ne mënyrë periodike (ditore, javore, mujore, vjetore).
6	Dërgimi i e-mail automatike ne rast te shfaqjes se problemeve teknike.
7	Dërgimi i e-mail automatike qe tregon statusin e tonerit dhe lajmërimi për ndërrimin e tij ne mënyrë proactive.
8	Krijimi i raporteve për sasinë e printimeve, fotokopjimeve, skanimeve për secilin user, departament, drejtori...etj.
9	Software duhet te ruaje ne databaze te gjithë aktivitetin e pajisjes dhe te mundësoje krijimin e raporteve mbi baze pajisjesh apo grupi pajisjesh. Krijimin e raporteve për kohen qe pajisjet kane ndenjor pa pune për arsye te problemeve teknike, krijimin e raporteve për kohen e shfaqjes dhe zgjidhjes se një problemi teknik dhe shpjegimin e natyrës se problemit te shfaqur.
10	Aplikacion Android dhe IOS për monitorimin e statusit te pajisjeve dhe lidhja e tij me Software.
11	Mundësimi për upgrade automatic me ane te Software te versioneve te fundit te firmëareve te pajisjeve.
12	Pull dhe secure printing te implementohet ne pajisjet qe kërkohet.
13	I gjithë sistemi duhet te jete automatik dhe te monitorohet nga një qendër e vetme.

**Specifikimet teknike te Letrës A4**

1	Letër fotokopje A4, 80 gr/m2 ngjyra e bardhe – letra duhet te jete brand i mirënjohur ndërkombëtar.	Risma 500 flete
---	---	-----------------

- **Serveri**

Serveri në të cilin do të instalohet Software që do të menaxhojë sistemin e monitorimit do të sigurohet nga ana e operatorit ekonomik.

- **Siguria e informacionit**

Palët bien dakord dhe konsiderojnë si rreptësisht konfidenciale të gjitha informacionet të komunikuar mes tyre në lidhje me aktivitetin e punës së AK-se dhe të mos bëjnë publike

informacione të tilla, tërësisht apo pjesërisht, çdo personi të tretë. Këto informacione të mos përdoren për ndonjë qëllim tjetër të ndryshëm nga sa përcaktohet në këtë marrëveshje.

Ofruesi i Shërbimit do të garantojë dhe bëjë të mundur që të gjithë punëmarrësit e tij të respektojnë konfidencialitetin për çdo dokument apo të dhëna që vijnë në dijeni gjatë ushtrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve. Në rast të shkeljes së detyrimeve të përcaktuara, AK-se ka të drejtë të zgjidhe menjëherë kontratën dhe të kërkojë ç' dëmtim për dëmin e shkaktuar. Ruajtja e konfidencialitetit do të vazhdojë për një afat të papërcaktuar edhe pas përfundimit të kësaj kontrate.

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.3.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.3.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.3.5 Në nenin 36, pika 3 “Specifikimet teknike”, Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve*

teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III 3.6 Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve ofertues, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Autoriteti kontraktor, në hartimin e specifikimeve teknike duhet t’i referohet nevojave të institucionit, duke analizuar dhe mirëargumentuar qartë nevojat e tyre, përcaktimin e specifikimeve teknike të pajisjeve që do të shërbejnë në realizimin e shërbimit të kërkuar.

III.3.7 Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues i cili kundërshton parametrat në lidhje me rezolucionin për pajisjet :

**Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A3, A4; Bardh e zi**  
Rezolucioni Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi të bëhet min 300x300 ose të hiqet si specifikim teknik

**Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A3 – Color**  
Rezolucioni Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi të bëhet min 600x600 ose të hiqet si specifikim teknik

“përcaktuar për pajisjet e kërkuar si parametra të ekzagjeruara dhe joproporcionale referuar volumit të punës, parametra/specifikime, të cilat kufizojnë në mënyrë artificiale konkurrencën”,

Komisioni vëren, se me argumentet e tij operatori ekonomik analizon hollësisht volumin e punës së AK-se dhe parametrat e vendosura për pajisjet e kërkuara. Referuar dokumentacionit të dosjes, Komisioni vëren, se Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e parametrave objekt - ankimi, referuar edhe Proces-Verbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”. Në një procedurë prokurimi është detyrë e njërive përkatëse të mirëargumentojë vendosjen e specifikimeve teknike (parametrave të pajisjeve) në mënyrë të hollësishme për të justifikuar bindshëm parametrat e vendosura për pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar ankesës, dokumentacionit të tenderit, si edhe informacionit të AK-së, gjykon, se për sa kohë rezolucioni i pajisjeve nuk ndikon në funksionalitetin në tërësi të pajisjes, si dhe referuar objektit të prokurimit “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e e pajisjeve informatike”, i cili është një shërbim me pajisje që nuk janë pronë e AK dhe çdo asistencë apo mosfunksionim me cilësi, është përgjegjësi e operatorit ekonomik fitues të përgjigjet për pajisjet e tij, gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë parametrat e ankimuara për të dyja pajisjet, duke i ulur ato në

proporcion me volumin të punës, në mënyre që të mos kufizohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “InfoSoft Office” SHPK, ku kërkon ndryshime në lidhje me specifikimet teknike si vijon, kundërshton:

**Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A3, A4; Bardh e zi**  
Memoria 2 GB/320GB HDD të bëhet ≥1Gbdhe memoria HDD të jëtë ≥ 250 GB

**Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A3 – Color**

Memoria 2 GB/320GB HDD të bëhet ≥256MB dhe memoria HDD të jëtë ≥ 250 GB

*“përcaktuar për pajisjet e kërkuara si parametra të ekzagjeruara dhe joproportionale referuar volumit të punës, parametra/specifikime, të cilat kufizojnë në mënyrë artificiale konkurrencën”,*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe ka detyrë të mirëargumentojë vendosjen e parametrave për pajisjet e kërkuara në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një numër të kufizuar pajisjesh, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktime fikse apo vlera të larta, në rastin konkret të memories së pajisjeve të sipërcituara, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me memorien e pajisjeve të kërkuara, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një diapazon minimum, pra të rishikojë parametrat e memories duke vendosur vlera më të ulëta .

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimesi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

## Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisony Comapy” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit



1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Erisony Comapy" SHPK dhe operatori ekonomik "InfoSoft Office" SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

